



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

CSR

Bankat për Shoqërinë



2022

BANKAT PËR SHOQËRINË



Përmbajtja

OBJEKTIVI 1	Pa Varfëri	4
OBJEKTIVI 2	Zero Uri	6
OBJEKTIVI 3	Shëndeti i Mirë dhe Mirëqënie	8
OBJEKTIVI 4	Arsim Cilësor	12
OBJEKTIVI 5	Barazi Gjinore	18
OBJEKTIVI 6	Ujë i Pastër dhe Kanalizime	20
OBJEKTIVI 7	Energji e Përbalueshme	21
OBJEKTIVI 8	Punë Dinjitoze dhe Rritje Ekonomike	23
OBJEKTIVI 9	Industri, Inovacion dhe Infrastrukturë	26
OBJEKTIVI 10	Zvogëlim i Pabarazive	28
OBJEKTIVI 11	Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme	30
OBJEKTIVI 12	Konsum dhe Prodhim i Përgjegjshëm	35
OBJEKTIVI 13	Veprim për Klimën	36
OBJEKTIVI 14	Jeta nën Ujë	39
OBJEKTIVI 15	Jeta në Stere	40
OBJEKTIVI 16	Paqe dhe Drejtësi, Institucione të Forta.....	41
OBJEKTIVI 17	Partneritet për Objektivat	43

OBJEKTIVAT PËR NJË ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM



OBJEKTIVI #1 Pa Varfëri

* Depërtimi i shërbimeve bankare në shoqëri luan rol të rëndësishëm në rritjen e përfshirjes financiare. Shërbimi që ofrojnë bankat në Shqipëri ka evoluar ndjeshëm, me një orientim të qartë drejt automatizimit dhe digjitalizimit.

Në fund të vitit 2022:

- **783** ATM
 - **400** degë të bankave në të gjithë vendin në mbështetje të institucioneve dhe komunitetit.
- * Mbi **24** milionë lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve dhe disa grupeve shoqërore (duke dalluar: *fëmijët, personat e papunë, personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara, gratë shtatzëna, të porsalindurit, viktimat e lëndimeve në punë dhe të varfrit dhe të pambrojturit*).

“Një dhuratë për ty” ishte tematika e festës së fund vitit organizuar nga **Credins Bank** në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, për fëmijët e familjeve në nevojë. Festës iu bashkuan dhe fëmijët e stafit të bankës.

Intesa Sanpaolo Bank Albania

- Mbështeti ndeshjen e futbollit “Match of Heart”, e organizuar në bashkëpunim me Ambasadën Italiane në Tiranë, Bashkinë e Tiranës dhe Tirana FC. Ky aktivitet sportiv u zhvillua më 11 tetor 2022, në stadiumin “Selman Stërmasi” dhe fondet e mbledhura nga shitja e biletave shkuan për bamirësi, konkretisht tek OJQ-të: “Sanita di Frontiera” dhe “Comunità di San Giuseppe”.
- Si çdo vit, iu bashkua fushatës së Fshatrat e Fëmijëve SOS për shitjen e kartolinave të fund vitit për mbledhjen e fondeve, në ndihmë të fëmijëve që kanë humbur kujdesin prindëror.
- Në bashkëpunim me divizionin ndërkombëtar të bankave filiale të Grupit Intesa Sanpaolo në datat 1-3 qershor 2022, organizoi për herë të parë në vendin tonë Kampin e Futbollit Atalanta. Në këtë aktivitet morën pjesë 120 fëmijë të moshës 8-12 vjeç nga familje në nevojë, fëmijë nga familje të klientëve të bankës dhe fëmijë të stafit.



Procredit Bank, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, kanë mundësuar restaurimin e çerdhes nr.4 në Kombinat. Investimet e kryera patën si synim në afatgjatë, përmirësimin e kushteve të qëndrimit për vogëlushët që frekuentojnë këtë çerdhe.

Projekte dhe përkujdes për shtresat në nevojë nga **Tirana Bank**:

- Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas dhe nën moton “Një ditë, shumë buzëqeshje” Tirana Bank, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, si dhe me praninë e aktorese së shquar Roza Anagnosti, festoi me zonjat në pamundësi ekonomike. Përfaqësues nga stafi i bankës ishin pranë mensës së Kryqit të Kuq, ku shërbyen drekën dhe qëndruan në shoqërinë e tyre.
- Tirana Bank mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Kryqi i Kuq me rastin e 150 vjetorit të themelimit, gjatë të cilit u shitën piktura të gjimnazistëve vullnetarë të Kryqit të Kuq Shqiptar. Të ardhurat nga shitja shkuan për familjet dhe shtresat në nevojë. Banka kontribuoi në blerjen e dy pikturave.

Raiffeisen Bank Shqipëri

Nëpërmjet nismës **Kujdesemi me zemër** u realizuan 5 projekte duke u gjendur pranë familjeve në nevojë, veçanërisht fëmijëve:

- Në qytetin e Shkodrës mundësoi festat dhe dhurata për 40 fëmijët e akomoduar në të dy Shtëpitë e Fëmijës. Gjithashtu u mundësua ngrohja e sallave të studimit si dhe blerja e dyshekëve të rinj për këto institucione.
- Dhuroi 250 pako me ushqime për disa nga familjet më në nevojë në Njësinë Bashkiake nr. 1 në Tiranë.
- Organizimi i teatrit me kukulla “Vajza e luleve” për fëmijët në nevojë në 10 qendra sociale.
- Nëpërmjet fondacionit të Stepic CEE Charity, me qendër në Vjenë, u gjend pranë fëmijëve në Ukrainë, të cilët u privuan për të jetuar magjinë e festave dhe për më tepër patën nevojë të plotësojnë nevojat më bazike të jetesës.
- Stafi i bankës në drejtorinë qendrore dhuroi në mënyrë vullnetare veshje dhe lodra për nënat dhe fëmijët në qendrën sociale të Bregut të Lumit në Tiranë.

Union Bank realizoi projektin e rindërtimit të 4 shtëpive të dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, në ndihmë të familjeve të prekura në Njësinë Administrative Ndroç. Shtëpitë u ri-konstruktuan tërësisht dhe u mobiluan me fondin e akorduar nga Union Bank në bashkëpunim edhe me Bashkinë e Tiranës. Fondit të akorduar nga Këshilli Drejtues i Union Bank iu bashkua edhe kontributi i qytetarëve, klientëve dhe stafit të bankës.

Me këtë rast, u organizua ceremonia e inaugurimit të njëjës prej këtyre shtëpive, ku znj. Flutura Veipi, Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive e Union Bank dhe znj. Keti Luarasi, zëvendës kryetare e Bashkisë së Tiranës, dorëzuan çelësin e shtëpisë së re për familjen e z. Myslym Korriku.



Kujdesemi me zemër
5 projekte me zemër për 2022

- 200 paketa me ushqime për familjet në nevojë në Tiranë
- Të ardhurat nga blerja e 10 dyshekëve sociale
- Dhurimi dhe hapja e 4 shtëpive të ri-konstruara në Njësinë Administrative Ndroç
- Stafi i bankës vullnetarë për blerjen e veshjeve
- Dhurimi për fëmijët në Ukrainë, nëpërmjet fondacionit Stepic CEE Charity

OBJEKTIVI #2 Zero Uri

* Financim i agro-bizneseve:

317 kredi të reja të dhëna gjatë vitit në vlerën **1.75** miliardë lekë.

Teprica e kredisë në fund të vitit 2022: **4.55** miliardë lekë.

Credins Bank dhe **Union Bank** ishin pjesëmarrëse në Panairin “Ditët e Bujqësisë 2022”, organizuar në datat 19-21 maj në Lushnjë, ku informuan vizitorët e shumtë për produktet dhe shërbimet e dedikuara që ofrohen për sektorin agro.

Gjatë ditëve të panairit stafi i **Credins Bank** i organizuar me degën lëvizëse (mobile branch) informoi fermerët e zonës duke ofruar alternativat më të mira si dhe ndihmuan banorët e zonës me shërbimet bankare falë degës lëvizëse.

Procredit Bank dhe **Union Bank** ishin ndër partnerët kryesorë dhe pjesëmarrës në panairin AgroTech Expo 2022, zhvilluar në datat 24-26 nëntor pranë Expocity Albania.

Procredit Bank, me qëllimin për të qenë sa më pranë nevojave dhe kërkesave të agrobizneseve, ishte pjese e seminarit informues “Digjitalizimi dhe përdorimi i teknologjisë në agrobiznes”, organizuar nga BERZH e mbështetur nga BE dhe Qeveria Shqiptare. Pjesëmarrës ishin fermerë dhe drejtues biznesesh që operojnë në prodhim apo tregtim produktesh vendase. Përveç kushteve lehtësuese në sigurimin e huamarrjes, agrobiznesi që investon merr 10% të financimit në formë granti në fund të realizimit të investimit.

* Mbi **3** milionë lekë donacione dhe mbështetje ndaj iniciativave për të siguruar ushqim në grupet në nevojë.

Banka Amerikane e Investimeve:

- Mbështeti Fondacionin Spitalor të Nënës dhe Fëmijës në projektin “Kutia e Gëzimit” për një periudhë 1 vjeçare, duke i dhuruar paketa për bebet e porsalindura në familjet në nevojë në të gjithë vendin.
- Me rastin e muajit të Ramazanit dhe festës së Bajramit, iu përgjigj kërkesës së Kryqit të Kuq dhe Komunitetit Mysliman Shqiptar për dhurimin e 150 paketave me produkte ushqimore, në mbështetje të familjeve në nevojë të qytetit të Tiranës.



Banka Kombëtare Tregtare (BKT) përqafoi nismën për mbledhjen e ndihmave për familjet dhe njerëzit në vështirësi financiare. Kjo fushatë u organizua nga Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Tiranë, për të ndihmuar familjet dhe njerëzit që jetojnë në kushte të vështira ekonomike. Në prag të festës së Kurban Bajramit, punonjësit e BKT-së në Tiranë dhe zonat përreth mbështetën këtë iniciativë në ndihmë të 85 familjeve duke dhënë ndihmë vullnetare në veshje, ushqime dhe produkte të higjienës personale.

Credins Bank vazhdon nismën “Food Bank”:

- Përgjatë muajit shkurt u shpërndanë 60 pako ushqimore në familje të qytetit të Gjirokastrës.
- Në mbështetje të organizatës jo fitimprurëse Papa Xhovani XX III në Shkodër ku u dhuruan 30 pako ushqimore si dhe disa mobilie për të përmirësuar ambientet e personave të cilët kjo organizatë ndihmon.
- Në rajonin e Vaut të Dejës u dhuruan 30 pako ushqimore.
- Në rajonin e Sarandës u dhuruan 60 pako me ndihma.
- Në bashkëpunim me Shoqatën Humanitare të Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë u dhuruan mbi 70 pako ushqimore për 70 familje të shërbimit PAK në Shkodër.
- Në fund të vitit shtroi një drekë për 50 persona të Qendrës Sociale “Gonxhe Bojaxhi”. Në këtë qendër ofrohen shërbime për familje e individë në nevojë, vakte ushqimore dhe shërbime të veçanta për personat me aftësi të kufizuara.

Në kuadër të nismave ndaj përgjegjësisë sociale dhe me rastin e festave të fund vitit, **OTP Bank Albania** ka kontribuar në shpërndarjen e ndihmave ushqimore për disa familje në nevojë, në Tiranë dhe rrethe. Paketat janë shpërndarë nga degët e bankës për familje të cilat marrin ndihmën ekonomike në degë.

Shoqata “Shqipëria” Vlorë, me mbështetjen e **OTP Bank Albania**, ofroi disa pako ushqimore për familjet në nevojë në qytetin e Vlorës.

Tirana Bank, në bashkëpunim të ngushtë me Kryqin e Kuq Shqiptar, mundësoi sigurimin e vakteve ushqimore ditore si dhe festimin e datëlindjeve, festave fetare dhe të fund vitit, për familjet, të pastrehët dhe pensionistët e pamundur që përfitojnë vaktet ushqimore në mensën e Kryqit të Kuq Shqiptar.



OBJEKTIVI #3 Shëndeti i Mirë dhe Mirëqenie

- * Financim për spitale private dhe për mbulim shpenzimesh për arsye shëndetësore:

94 kredi të reja të dhëna gjatë vitit në vlerën **1.39** miliardë lekë.

Teprica e kredisë në fund të vitit 2022: **3.56** miliardë lekë.

- * Politikat për sigurimin e shëndetit të punonjësve

Bankat aplikojnë politika për sigurimin e shëndetit të punonjësve, të cilat përfshijnë sigurimin privat të shëndetit dhe paketa të kujdesit parandalues (check-up) që kryhet 1 herë në vit. Gjithashtu, punonjësve u ofrohen paketa ose karta sigurimi shëndetësor me kushte preferenciale për familjaret e tyre, në zgjedhje individuale sipas interesit.

- * Mbi **2.8** milionë lekë sponsorizime për spitale, klinika dentare, pajisje mjekësore.

Disa nga projektet e mbështetura nga bankat:

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti përmirësimin e mjediseve të Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijë në Tiranë.

Raiffeisen Bank kontribuoi në blerjen e pajisjeve mjekësore për qendrën shëndetësore Fushë Krujë si dhe për repartin e pediatriisë në spitalin Sarandë.

- * Iniciativa të ndërmarra nga bankat në kuadër të përgjegjësisë sociale të korporatave, në vlerë rreth **4** milionë lekë.

Banka Kombëtare Tregtare mbështet dhe ndërgjegjëson klientët dhe stafin e tij për aktivitete që promovojnë mënyrë jetese të shëndetshme.

- Tetori Rozë - Për të rritur ndërgjegjësimin për kancerin e gjirit, stafit të bankës iu dhuruan fjongo rozë dhe në rrjetet sociale u publikua një video ndërgjegjësuese. Në ambientet e bankës u ftua edhe një mjeke onkologe e cila ndau këshilla për vetëkontrollin dhe kujdesin.
- Në kuadër të bashkëpunimit me Federatën Shqiptare të Basketbollit, banka mbështeti aktivitetin "Summer

Tour” 3x3 i cili u dha mundësinë shumë skuadrave të marrin pjesë në këtë konkurs novator.

- Në bashkëpunim me Akademinë Sportive Galaktikking, mbështeti Kampionatin e Basketbollit U10.
- Mori pjesë në nismën e ndërmarrë nga bashkia “Në punë me biçikletë”, duke i ftuar punonjësit e saj të përqafojnë këtë mënyrë transporti. Gjithashtu, për të rritur ndërgjegjësimin promovoi në rrjetet sociale një video të punonjësve të saj të cilët përdorin biçikletat për të shkuar në punë.

Credins Bank mbështeti:

- Maratonën Malore zhvilluar në Petrelë ku morën pjesë 250 vrapues të moshave të ndryshme nga Shqipëria dhe vende të tjera.
- Kampionatin e Taekwondo në kuadër të 10 vjetorit të Taekwondo Studenti.
- Mbulimin e shpenzimeve të Klubit Sportiv Studenti për disa artikuj të nevojshëm. Ky klub përfshin ndeshje dhe organizime për disiplina të ndryshme, si çiklizëm, basketboll, volejball, karate, peshëngritje, etj..
- Maratonën “Tiranaolon”, një aktivitet ku morën pjesë garues të sporteve të ndryshme si vrap, çiklizëm dhe not.

Fibank Albania:

- “Tjetër herë me vajzë” është fushata e nisur nga UNFPA në partneritet me Fondacionin Spitalor të Nënës dhe Fëmijës. Statistikat tregojnë se në Shqipëri lindin 109 djem për çdo 100 vajza, ose, e thënë ndryshe, për çdo 10 djem të lindur vendi humbet një vajzë. Për të ndikuar në ndërgjegjësimin e shoqërisë, fushata synon të ndikojë përmes informimit dhe debatit publik, me qëllim që familjet dhe prindërit të jenë më të përgjegjshëm për vendimet që marrin.
- Në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës ndaj grave dhe në prani të përfaqësuesve nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Bashkia Tiranë, Komisionari për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe partnerëve zbatues nga institucione shtetërore dhe shoqëria civile, Fibank Albania ishte pjesë e hapjes së ekspozitës me fotografi të vajzave shqiptare dhe siluetave të atyre vajzave që mungojnë mes nesh. Ekspozita u zhvillua në pedonalen e Tiranës deri në datën 18 dhjetor dhe ishte e hapur për të gjithë.



TJETËR HERË ME VAJZË!

Kërkojme goca modele moshë 0-18 vjeç për tu bërë pjesë e kalendarit të fushatës ndërgjegjëse “Tjetër herë me vajzë!”



- Mbështeti Federatën Shqiptare të Skive në zhvillimin e sportit të skive në zonat Shishtavec, Borje dhe Pukë. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm ambasadori i Bullgarisë në Tiranë z. Momtchil Raytchevski, Drejtori i Përgjithshëm i Fibank Albania, z. Bozhidar Todorov, Presidenti i Komitetit Olimpik për Shqipërinë z. Fidel Ylli dhe Presidenti i Federatës Shqiptare të Skive, z. Elvis Toci.

Intesa Sanpaolo Bank Albania:

- Përgjatë muajt tetor i është bashkuar fushatës ndërgjegjësuese për diagnostikimin e hershëm të kancerit të gjirit. Në datën 24 tetor, mundësoi një “Photo Booth” në ambientet e degës pranë zyrave qendrore. Stafi i bankës, por edhe klientët iu bashkuar fushatës dhe bënë foto individuale apo në grup që përmbanin mesazhe frymëzuese e sensibilizuese, të cilat mund t’i postonin dhe në rrjetet e tyre sociale për të përcjellë mesazhet tek një audiencë më e gjerë. Gjithashtu, punonjësve të bankës iu mundësua një material edukativ dhe informues mbi kontrollet e nevojshme periodike, si dhe faktorët e rrezikut që ndikojnë tek kanceri i gjirit, i përgatitur nga Medical Response for Diplomatic Corps (MRDC).
- Gjatë vitit 2022, promovoi ditë të ndryshme ndërkombëtare që lidhen me shëndetin, si: Dita Botërore e Shëndetit, Dita Botërore e Sindromës Down, Dita Botërore e Gjakut, Dita Botërore për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Dita Botërore kundër Duhanit, Dita Botërore e Ndërgjegjësimit për Autizmin, etj.
- Në kuadër të Ditës Botërore të Diabetit, ndau me të gjithë stafin një material informues të përgatitur nga Medical Response for Diplomatic Corps.
- Nga data 23 deri më 25 shtator mori pjesë në aktivitetin sportiv ISBD, të zhvilluar në Poreç, Kroaci. Veprimtaria riktheu frymën e lojës dhe bashkëpunimin mes sportdashësve nga vende të ndryshme të botës. Rreth 800 pjesëmarrës garuan në ndeshje futbollit, basketbollit dhe volejbollit.

OTP Bank Albania:

- Sponsorizoi Konferencën Kombëtare të Shkencave Mjekësore 8. Ky aktivitet u organizua për të 8-in vit radhazi, si pikë bashkimi e profesionistëve nga e gjithë Shqipëria. Për shkak edhe të kushteve të krijuara nga pandemia, u mbajt në Tiranë dhe në rrethe paralelisht, si dhe u organizuan 10 webinarë.
- Mbështeti klubin e basketbollit “Partizani” (meshkuj). Qëllimi ishte realizimi i objektivave të skuadrës dhe përfaqësimi sa më dinjitoz në ndeshjet e ligës superiore. Gjithsej u zhvilluan 15 ndeshje nga të cilat 5 prej tyre ishin ndeshje për kupë për kategoritë A dhe B.

DHURIM VULLNETAR GJAKU

Tashmë një traditë që organizohet prej vitesh me pjesëmarrjen vullnetare të stafit të bankave për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve talasemikë.

Banka Amerikane e Investimeve, Banka Kombëtare Tregtare, Intesa Sanpaolo Bank Albania, OTP Bank Albania, Union Bank.



MARATONA E TIRANËS 2022

Bankat nxisin punonjësit e tyre të jenë pjesë e aktiviteteve që promovojnë një jetë të shëndetshme dhe risin ndërgjegjësimin për reduktimin e përdorimit të mjeteve motorike.

Banka Kombëtare Tregtare, Fibank Albania, Intesa Sanpaolo Bank Albania, OTP Bank Albania dhe Raiffeisen Bank Shqipëri, më 23 tetor iu bashkuan edicionit të 6-të të Maratonës.



OBJEKTIVI #4 Arsim Cilësor

Bankat shërbejnë si një shtyllë e rëndësishme e edukimit financiar, duke ofruar burime të vlefshme dhe mbështetje për të orientuar individët dhe bizneset në botën komplekse të financave. Nisur nga shërbimet bazë bankare dhe deri tek opsionet për investim, huat dhe planifikimi i financimit, bankat janë të përkushtuara për të fuqizuar konsumatorët e tyre me njohuritë e nevojshme për të bërë zgjedhjet e duhura financiare.

* Financim i shpenzimeve të arsimit:

42 kredi të reja të dhëna gjatë vitit në vlerën **1.13** miliardë lekë.

Teprica e kredisë në fund të vitit 2022: **4.67** miliardë lekë.

* Sponsorizime për shkollat dhe për pajisjet e tyre me laboratorë apo përmirësim kushtesh në vlerën **3.8** milionë lekë.

Banka Kombëtare Tregtare ka mbështetur institucione të ndryshme arsimore në Tiranë, Kamëz dhe Vlorë, për të përmirësuar kushtet në shkolla në këto qytete.

Credins Bank dhuroi pajisje kompjuterike për shkollën 9-vjeçare Kolë Koçi, Zyra Vendore Arsimore Pogradec, për t'i ndihmuar në mësimdhënie dhe mbarëvajtje më të mirë të procesit mësimor.

Zhvillimi i sistemit arsimor është një ndër pikat kryesore ku **OTP Bank Albania** ka dhënë kontributin e saj:

- Dhuroi pajisje kompjuterike, mjete të printimit dhe uniforma pune sipas nevojave të shkollës “Enver Qiraxhi” në Pogradec duke realizuar në këtë mënyrë një objektiv arsimor të suksesshëm, më tepër praktikë profesionale dhe kryerjen me cilësi të detyrimit pedagogjik.
- Mbështeti projektin “#you/th meant for greatness” udhëhequr nga shoqata World Vision me fokus organizimin e klasave mësimore pas-shkollore për fëmijët dhe të rinjtë në nevojë të shkollës “Ibrahim Basha” në qytetin e Tiranës. Programi filloi në datën 5 maj dhe zgjati deri në përfundim të vitit shkollor, qershor 2022. Orët pas-shkollore që u organizuan ishin në lëndët: gjuhë shqipe, letërsi dhe matematikë.

Raiffeisen Bank:

- Mundësoi ndërtimin e laboratorëve kompjuterik për 3 (tre) shkolla në Tiranë: “Aleks Buda”, “Osman Myderizi” dhe “Servete Maçi”.
- Ofroi mjetet shkollore për fëmijët e Shtëpisë së Fëmijës në Tiranë.

* Mbi **5** milionë lekë në mbështetje të aktiviteteve të ndryshme organizuar me nxënës të shkollave

JAVA E PARASË

Në datat 21-27 mars, Shoqata Shqiptare të Bankave, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, festuan Javën e Parasë 2022, nën sloganin “Tregohu i zgjuar me paranë, ndërto të ardhmen tënde!”. Në aktivitetet e organizuara gjatë kësaj jave morën pjesë mbi 2,800 nxënës dhe studentë nga 150 shkolla të niveleve të ndryshme.

Banka Kombëtare Tregtare, Credins Bank, OTP Bank Albania, Raiffeisen Bank dhe Union Bank mundësuan çmimet për fituesit e 5 konkurseve të shpallura nga Banka e Shqipërisë dhe AAB.

Gjithashtu, u organizuan leksione të hapura me temën Rinia dhe Bankingu Digjital. Përfaqësuesit e **Intesa Sanpaolo Bank Albania, Raiffeisen Bank, Credins Bank, Union Bank, OTP Bank Albania**, iu drejtuan studentëve për t'i ndërgjegjësuar mbi rëndësinë e kulturës financiare si pjesë e formimit të përgjithshëm. Gjatë leksioneve u prezantua orientimi dhe përparësia që bankat kanë drejt plotësimit të nevojave të klientëve nëpërmjet kanaleve digjitale si rrjedhojë e ndryshimit të sjelljes konsumatore.



PANAIRE NË UNIVERSITETE

Tashmë është traditë që bankat të jenë pjesë aktive dhe të mbështesin panairt e Punës dhe Karrierës që organizohen nga universitete të ndryshme në Shqipëri. Qëllimi i këtyre panairëve është informimi i studentëve për mundësitë e ndryshme që bankat ofrojnë për studentët që kanë përfunduar studimet dhe duan të mësojnë nga praktikat më të mira bankare.

Credins Bank, Fibank Albania, Intesa Sanpaolo Bank Albania, Union Bank ishin pjesëmarrëse në disa panairt të punës dhe karrierës të organizuar në bashkëpunim me institucione të ndryshme, si: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë; Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës; Universiteti “Epoka”; Universiteti “Marin Barleti”; Universiteti European i Tiranës; Kolegji Universitar Qiriazi; Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër; Universiteti Metropolitan, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, etj..

Banka Kombëtare Tregtare:

- Në bashkëpunim me DSIK Albania dhe AAB-në, ishte pjesë e disa nismave të ndryshme për krijimin e kulturës edukativo-financiare tek fëmijët. U kryen vizita në disa shkolla të kryeqytetit (Shkolla 9-vjeçare “Halit Coka”; Shkolla 9 vjeçare “Mustafa Kemal Atatürk”), gjatë të cilave u zhvilluan trajnime në formë loje për njohuritë bazë rreth financave.
- Mbështet projekte që synojnë promovimin e inovacioneve dhe në bashkëpunim me Fakultetin Ekonomik mbështeti aktivitetin “Gratë në Fintech”, me fokus përdorimin e teknologjisë së re për zgjidhjen e problemeve

në çdo disiplinë.

- Mbështeti Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës në organizimin e konkursit Young Innovators më datë 18 maj, në kuadër të përmbylljes së lëndës së inovacionit. Të pranishëm rreth 250 studentë të vitit të tretë në degët e Administrim Biznesit dhe Informatikës Ekonomike.
- Organizoi një aktivitet me fëmijët e shkollës World Academy of Tirana (WAT), duke i mësuar se si të kujdesen për paratë, si të kursejnë, si të fitojnë të ardhura përmes sipërmarrjes dhe të hedhin themelet për të ardhmen dhe mirëqenien e tyre.




Credins Bank:

- “Akseleratori Uplift Albania 2021”, mbajti finalen e Demo Day në fillim të vitit dhe banka dhuroi mbështetje si dhe mori pjesë në ceremoninë e finales.
- Përgjatë gjithë vitit mbështeti programin Tirana Inc i cili mblodhi bashkë studentë të disa universiteteve në Tiranë të cilët dhanë idetë e tyre inovative për startup-e në fusha e industri të shumta, dhe me partnerë ndërkombëtarë, si: EU for Innovation; Preneurz Amsterdam; si dhe GIZ. Credins bank, si një nga mbështetësit, ishte pjesë edhe e finales ku shpërndau çeqet për fituesit.
- Mbështeti Konferencën Kombëtare të Shkencave Mjekësore me mbi 500 lektorë dhe 100 profesorë të huaj.
- U gjend pranë studentëve të Fakultetit Evropian të Tiranës, pjesëmarrës në Konkursin “Forumi i Studenteve të Financës”, ku konkurruan me idetë e tyre në lëndën “Tregjet Financiare”. Tema për këtë vit ishte “Green Economy and Financial Challenges”, ku u ndanë çmime për fituesit si dhe u dha një mundësi tepër e vlefshme për praktikë pune pranë bankës Credins.
- U dhuruan 210 libra për bibliotekën publike në Korçë.

Fibank Albania mbështeti realizimin e projektit “Të Sigurt për në Shkollë, Të Sigurt për në Shtëpi” nga Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Tiranë, i cili ka për qëllim edukimin e fëmijëve me rregullat e qarkullimit rrugor. Një pjesë e rëndësishme e projektit është trajnimi i stafit pedagogjik për dhënien e ndihmës së parë në aksidentet që mund të ndodhin brenda mjedisit shkollor. Vullnetarët e ndihmës së parë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, u mësuar fëmijëve rregullat e qarkullimit rrugor, si dhe disa teknika të ndihmës së parë në rast aksidentesh.

Intesa Sanpaolo Bank Albania:

- Më datë 30 qershor u organizua konkursi “Eco-Quiz” me pjesëmarrjen e 120 fëmijëve të moshës 13 - 16 vjeç në Qendrën TUMO. Ky konkurs u drejtua nga Muzeu i Kursimeve (Museo del Risparmio) dhe Grupi Intesa Sanpaolo në bashkëpunim me Divizionin Ndërkombëtar të Bankave Filiale, Intesa Sanpaolo Bank Albania dhe Qendrën TUMO Tirana. Fëmijëve të ekipit fitues iu mundësua një udhëtim kulturor dhe mësimor në Torino të Italisë, me të gjitha shpenzimet e përfshira, në datat 23 - 25 shtator.
- Më datë 25 mars, z. Alessandro D’Oria, Drejtor Ekzekutiv i Intesa Sanpaolo Bank Albania, dhe z. Julian Çela, Drejtor i Divizionit Financiar, prezantuan një leksion të hapur rreth buxhetit dhe pasqyrave financiare me prezencën



e 100 studentëve të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative në Universitetin Epoka.

- Në kuadër të aktiviteteve të Javës Globale të Parasë, në ambientet e “Albanian Collage” në Tiranë, përfaqësues të bankës organizuan një orë mësimi të hapur me nxënës të klasës së katërt dhe të pestë në lidhje me rëndësinë e sigurisë në internet.
- Më 31 maj organizoi leksion të hapur në ambientet e Universitetit Epoka në kuadër të Muajit Ndërkombëtar të Ndërgjegjësimit për Auditimin e Brendshëm.
- Intesa Sanpaolo Bank Albania iu bashkua aktiviteteve të organizatës “New Vision” për një vizitë studimore me temë “Sipërmarrës për një ditë” në ambientet e Zyrave Qendrore. Gjatë vizitës u shpjegua historiku i bankës, funksionimi i departamenteve, menaxhimi i burimeve, burimet njerëzore, struktura organizative, etj.
- Banka mbështeti konkursin “Inovatorët e Rinj” me pjesëmarrjen e 250 studentëve të organizuar nga Universiteti i Tiranës dhe i akordoi anëtarëve të grupit fitues një kontratë pune 6-mujore pranë strukturave të retail në Zyrat Qendrore.
- I kushton vëmendje të veçantë Ditës Botërore të Kursimeve dhe e promovon atë nëpërmjet aktiviteteve të Muzeut të Kursimeve. Konkursi “S.A.V.E. Ambassadors” është nisma e parë e përbashkët me fokus të rinjtë e shkollave të mesme nga Shqipëria, Bosnja & Hercegovina, Kroacia, Egjipti, Hungaria, Moldavia, Rumania, Serbia. Ky është një format i krijuar nga Muzeu i Kursimeve dhe Banka Evropiane e Investimeve (EIB) dhe synon t'i afrojë të rinjtë me temat e qëndrueshmërisë, ekonomisë qarkulluese, përfshirjes sociale dhe edukimit financiar. Gjatë muajit nëntor, u mbajt një sesion informues nga përfaqësues të bankës në secilën nga klasat pjesëmarrëse të tre gjimnazeve në Tiranë, përkatësisht “Sami Frashëri”, “Ismail Qemali” dhe “Ernest Koliqi”. Nxënësve iu kërkua të përzgjedhin një nga sfidat e pazgjidhura në qytetin e tyre në aspektin mjedisor dhe social, si dhe të propozonin alternativa dhe ide për t'i zgjidhur ato. Përveç çmimit, klasa fituese caktohet si “S.A.V.E. Ambassador” dhe përfaqëson vendin në konkursin ndërkombëtar. Tetë projektet më të mira, një për secilin vend ku ka prezencë Divizioni Ndërkombëtar i Bankave Filiale të Grupit Intesa Sanpaolo, u vlerësuan në vijim gjatë një aktiviteti online. Në mbyllje të aktivitetit, u mbajt një ceremoni për ndarjen e çmimeve për tre vendet e para në linjë me temën e konkursit dhe klasës fituese iu dhurua një hapësirë pyjore e mbjellë me 30 pemë e vendosur në një nga vendet në zhvillim. Grupet e dyta dhe të treta u shpërblyen me mundësinë për të adoptuar 20 arinj polarë dhe 10 breshka detare, të cilat janë specie në rrezik zhdukje në bashkëpunim me WWF.
- Më datë 14 dhjetor nxënës të gjimnazit “Turgut Özal” Tiranë, pjesë e Klubit të Ekonomisë, vizituan ambientet e Zyrave Qendrore të Intesa Sanpaolo Bank Albania, ku mundësua dhe takim me drejtues të lartë të bankës.

OTP Bank Albania:

- Departamenti i Burimeve Njerëzore, në kuadër të Javës së Parasë, ka zhvilluar sesione të edukimit financiar për fëmijë. 70 fëmijë të shkollës fillore “Ylber” u bënë pjesë e këtij sesioni të hapur.



- Organizimi i sesionit “Aftësitë e nevojshme për tregun e punës së të ardhmes” nga Departamenti i Burimeve Njerëzore me Kolegjin Universitar Qirazi me pjesëmarrjen e 25 studenteve të fushave të ndryshme të këtij universiteti.
- Në edicionin e tij të tretë, Start – Up City u organizua në bashkëpunim me Universitetin Metropolitan Tirana, ku u përzgjedhën idetë më të mira, duke bërë të mundur zhvillimin e tyre të mëtejshëm në treg. Start-Up City u zhvillua në tre muaj radhazi dhe u finalizua në datat 13-14 maj, ditë në të cilat u ndanë dhe çmimet e fituesve.

Raiffeisen mbështeti kampin veror “Korca ICT Youth Academy”, i dedikuar për programuesit e rinj.

Tirana Bank:

- Partneriteti i Bankës me Junior Achievement konsistoi në realizimin me sukses të aktivitetit me tematikë “Konkursi dhe Panairi Kombëtar i Nxënësve”. Panairi konsiderohet si aktiviteti kulmor pas 9 muajve trajnime të vazhdueshme dhe ndjekje të moduleve me zgjedhje “Drejtues për një ditë” dhe “Kompania e nxënësve” që Junior Achievement Albania ka realizuar për klasat 10,11,12 të shkollave në rang vendi. Fitues të çmimit të parë ishin vajzat dhe djemtë e NEXUS si shoqëria sipërmarrëse më e mirë e vitit 2022, për mënyrën e organizimit të punës dhe praktikitetin e produktit të tyre.
- Konkursit “Sfida e Biznesit” organizuar nga Tirana Bank në partneritet me B4Students, iu bashkuan me propozimet e tyre studentët pjesëmarrës, 9 prej të cilëve u kualifikuan për fazën finale. Fituesve iu mundësua shpërblim monetar, trajnim profesional në platforma ndërkombëtare online si edhe pjesëmarrja në programin e praktikës profesionale dhe punësimit në shoqëritë e Grupit BALFIN.




Union Bank, në bashkëpunim me Protik Innovation Center, organizoi një ditë të hapur me studentë të fushës së teknologjisë së informacionit (IT). Gjatë këtij aktiviteti studentët patën mundësinë të njihen me veprimtarinë e Union Bank, zhvillimet teknologjike të fundit, si pjesë e transformimit digjital të saj. Ky organizim ishte një mundësi për studentët për t’u njohur gjithashtu me hapësirat dhe mundësitë e zhvillimit të karrierës që banka ofron në profilet e fushës së IT.

- * Programe të praktikave profesionale (intershipi) për studentë, të organizuara gjatë vitit.

Banka Amerikane e Investimeve, Banka Kombëtare Tregtare, Credins Bank, OTP Bank Albania, Raiffeisen Bank, Tirana Bank, Union Bank ofrojnë mbështetjen e tyre për edukimin dhe punësimin e brezit të ri nëpërmjet një sërë projektsh bashkëpunuese me universitetet më të mira publike dhe private në Shqipëri.

Gjatë vitit janë mundësuar praktika mësimore, 1 deri 3 mujore, për më tepër se 300 studentë të cilët kanë mbaruar ciklin e tyre të studimeve në shkenca ekonomike, kompjuterike, etj.

Banka Amerikane e Investimeve, Banka Kombëtare Tregtare dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania i u bashkuan Programit Kombëtar të Praktikave të



Punës. Ndër studentët që aplikuan, u përzgjedhën për praktika mësimore 3 mujore si dhe u ofruan mundësi të mëtejshme punësimi.

Banka Kombëtare Tregtare mbështet edukimin dhe punësimin e brezit të ri nëpërmjet një sërë projektesh bashkëpunuese me universitetet më të mira publike dhe private në Shqipëri. Konkretisht:

- Mbështet UNYT-në me një program të integruar me praktikën: “Banka dhe Financa e Aplikuar”. Banka ka ofruar bursa të plota për 11 studentët më të mirë që ndjekin programin e studimeve bachelor, praktikë verore me pagesë dhe kontratë pune pas diplomimit me sukses.
- Ka nënshkruar një marrëveshje me Fakultetin e Shkencave të Natyrës duke ofruar bursë të plotë për 7 studentë që ndjekin programin Master Profesional në Informatikë Biznesi dhe duke u ofruar atyre mundësi praktike me pagesë. Një grup prej 10 studentësh ndjekin Akademinë “BKT FinTech” me programe intensive profesionale Fintech, në përgatitje për punësim të ardhshëm në bankë.
- Mbështeti studentët e Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikë në Menaxhimin e Bankës (FASTIP) në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, për të pesëmbëdhjetin vit radhazi. Studentët e FASTIP-it përfitojnë bursa dhe programe praktike gjatë vitit. Nëntë studentë të programit të studimit Bachelor iu bashkuan bankës si punonjës pas diplomimit të tyre.

“Digital Banker” ishte një nismë e **Tirana Bank** Students Hub e cila krijoi një hapësirë për studentët e talentuar, të cilët ndoqën praktikën e bankingut digjital në rrjetin e degëve, dhe puna e tyre vlerësohej në bazë të parametrave javorë, njëllëj sikur të ishin punonjës të bankës.

* Projekte të mbështetura në kuadër të Përgjegjësisë Sociale të Korporatave në vlerën mbi **1.4** milionë lekë.

Credins Bank:

- Në mbështetje të fëmijëve në nevojë, ka udhëtuar nëpër rrethe të ndryshme duke dhuruar çanta mbushur me mjete shkollore. Përkatësisht u gjend pranë:
 - ▢ 34 fëmijëve në Sarandë,
 - ▢ 20 fëmijëve në Shkodër,
 - ▢ 20 fëmijëve në Korçë, dhe
 - ▢ 63 fëmijëve në Kavajë.
- Mbështeti shkollën Janaq Kilica, Zyra Vendore Arsimore Fier në ceremoninë e diplomimit të nxënësve.
- Dhuroi libra për nxënësit e shkollës së mesme të bashkuar artistike “Ajet Xhindole”. Dhurimi u krye për gjatë koncertit për piano “Nën tingujt klasik të pianisteve të rinj”, i cili u zhvillua për herë të parë në Qendrën Kulturale “Margarita Tutulani” në Berat.

OTP Bank Albania:

- Në mbështetje të artit dhe edukimit të fëmijëve për përqafimin e tij, mbështeti projektin 4-ditor “Punishtja e Elfëve”, i cili synon të edukojë fëmijët nëpërmjet teatrit.
- “Mashtruesit financiarë, nga Ponzio...te Madoff” nga Adrian Civici është libri i cili doli në treg me mbështetjen e bankës. Ky libër është rezultat i një pune disavjeçare të autorit, i cili solli për lexuesin historitë e skemave më të mëdha piramidale botërore, dhe jo vetëm.
- Falë programit “Dhuro Kulturë” nga fondacioni “Arte”, banka dhuroi një piano, për nxënësit e shkollës “Jeronim de Rada”.
- Sponsorizoi panairin online të librit. Dashamirësit e librit e ndoqën të gjithë panairin nëpërmjet platformave virtuale.

OBJEKTIVI #5 Barazi Gjinore

Në fund të vitit 2022, bankat kishin gjithsej **6,742** punonjës nga të cilët:

611 Numri i femrave në pozicione drejtuese.

4,968 Numri gjithsej i gjinisë femërore në bankë.

* Hua për SME që drejtohen nga femra

140 kredi të reja të dhëna gjatë vitit në vlerën **1.16** miliardë lekë.

Teprica e kredisë në fund të vitit 2022: **1.68** miliardë lekë.

* Rreth **2** milionë lekë kontribut nga bankat në mbështetje të institucioneve dhe projekteve për komunitetin.

Banka Amerikane e Investimeve mbështeti edicionin e parë të Fem – Fest në Shqipëri, në datat 5-8 mars, i cili synoi ndërgjegjësimin e opinionit publik për të drejtat e grave nëpërmjet shfaqjeve, instilacioneve, ekspozitave, tryezave të diskutimit dhe mundësive për artistet e reja.

Banka Kombëtare Tregtare (BKT):

- Mbështeti dhe ishte pjesë e aktivitetit për Ditën Ndërkombëtare të Gruas, 8 Mars 2022 (IWD 2022), “Barazia Gjinore sot për një të ardhme të qëndrueshme”, duke njohur kontributin e grave dhe vajzave në mbarë botën.
- Z. Seyhan Pencablilil, Drejtor Ekzekutiv dhe Anëtar Bordi i BKT-së, mori pjesë në ekspozitën “Unë kam



një ëndërr” të fotografes Jutta Benzenberg në bashkëpunim me UN Women në Shqipëri. Nëpërmjet objektivit të saj, fotografja synonte të sillte vëmendjen tek ëndrrat e vajzave shqiptare nga zonat rurale të vendit, si dhe për të bërë thirrje për angazhimin shoqëror për të promovuar të drejta të barabarta për gratë dhe për të thyer stereotipat gjinore.

- Iu bashkua nismës vjetore të UN Women Albania “16 Ditë Aktivizim kundër Dhunës me Bazë Gjinore”. Duke filluar nga data 25 nëntor, Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, dhe deri më 10 dhjetor, banka shpërndau në rrjetet e saj sociale dhe rrjetin e ATM-ve, video dhe mesazhe ndërgjegjësuese kundër dhunës, si edhe ndryshoi ngjyrën e logos në portokalli, ngjyrë që shoqëron këtë fushatë dhe simbolizon një të ardhme të ndritur dhe pa dhunë për gratë. Po në kuadër të fushatës, BKT mbështeti financiarisht strehën e grave në Elbasan nën kujdesin e shoqatës “Forumi i Gruas”.

Fibank Albania:

- Përgjatë vitit, i kushtoi një dhuratë të veçantë çdo klienti të parë të gjinisë femërore në degët e bankës.
- Prezantoi programin “Smart Lady”, dedikuar për bizneset (persona fizikë ose shoqëri) në pronësi ose të drejtuara nga gra, ose që prodhojnë produkte dhe shërbime për gratë. Në bashkëpunim me projekte të ndryshme ky produkt mbështet edhe financimin e aktiviteteve start – up.

Intesa Sanpaolo Bank Albania

- I’u bashkua fushatës së UN Women Albania “UNITE! Aktivizëm për t’i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave”, një iniciativë prej 16 ditësh aktivizmi kundër dhunës me bazë gjinore.
- Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Grave dhe Vajzave në Shkencë, përgatiti dhe shpërndau një kartolinë për të gjithë punonjësit e saj, duke qenë se banka ka një nga objektivat e saj kryesor arritjen e barazisë gjinore në punë. Banka synon të krijojë edhe më shumë mundësi për të gjitha gratë e talentuara në fusha të ndryshme të shkencës, duke ofruar vende të reja pune, si dhe produkte financiare të dedikuara veçanërisht për zhvillimin e tyre profesional.

Banka Kombëtare Tregtare dhe Procredit Bank kanë nënshkruar Parimet e Fuqizimit të Grave (WEP), të cilat janë një grup parimesh që ofrojnë udhëzime për biznesin se si të promovojnë barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në vendin e punës, treg dhe komunitet. Parimet janë mjeti kryesor për ofrimin e korporatave në dimensionet e barazisë gjinore të agjendës së vitit 2030 dhe Objektivave të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm.



OBJEKTIVI #6 Ujë i Pastër dhe Kanalizime

* Praktika në zbatim nga bankat

Në rrjetin **Intesa Sanpaolo Bank Albania** (Zyrat Qendrore dhe degët) harxhohet mesatarisht në muaj 8,500 litra ujë i pijshëm, i cili nuk mungon asnjëherë. Gjithashtu, shërbimi sanitar është i vazhdueshëm në Zyrat Qendrore dhe degët e Bankës.

Data 22 Mars shënoi Ditën Botërore të Ujit dhe me rastin e kësaj banka shpërndau një kartolinë për të gjithë punonjësit e saj për të rritur ndërgjegjësimin. Mbi 2.2 miliardë njerëz jetojnë pa qasje në ujë të sigurt.



OBJEKTIVI #7 Energji e Përbalueshme

* Hua për energji të rinovueshme

178 kredi të reja të dhëna gjatë vitit në vlerën **7.52** miliardë lekë.

Teprica e kredisë në fund të vitit 2022: **8.71** miliardë lekë.

* Zhvillime në fushën e energjisë së rinovueshme mbi **45** milionë lekë

Banka Kombëtare Tregtare, në kuadër të politikave për sigurimin e energjisë, në tarracat e dy godinave kryesore të saj (BKT Lundër 1 & Kapanoni BKT në Kashar) ka filluar gjatë vitit 2022 dhe planifikuar për t'u montuar dhe gjatë vitit 2023 impiante fotovoltaike. Përfitimet nga kjo zgjidhje janë:

- ☉ Mundësim i prodhimit të energjisë Fotovoltaike dhe mbulim i nevojave të konsumit nëpërmjet Impiantit Fotovoltaike të sinkronizuar në rast mungese nga rrjeti.
- ☉ Ulja e konsumit të lëndës djegëse (dizel) nga gjeneratori në minimum.
- ☉ Ulja e emetimit të dioksidit të karbonit (CO₂).

Pas kryerjes dhe përfundimit të studimeve të leverdisë ekonomike, ky investim mund të vijojë në të gjitha godinat e BKT.

Intesa Sanpaolo Banka Albania është New Own Emissions Plan (OEP), një veprim i përbashkët i drejtuar nga Grupi për të arritur objektivat Net-Zero në 3 (tre) fusha kryesore: Emetimet indirekte nga konsumi i energjisë, emetimet direkte dhe letra.

a) Emetimet indirekte nga konsumi i energjisë:

☉ Konsumi i energjisë për ngrohje qendrore:

Rinovimi i 3 Degëve (dy degë në Tiranë dhe një në qytetin e Vlorës) duke zëvendësuar pajisjet ekzistuese me ato me efikasitet të lartë si sistem AC, gjeneratorë, ndriçim LED. Këto investime janë në përputhje me iniciativat ESG të Grupit.

☉ Instalimi i sistemeve të monitorimit:

Në fund të vitit 2022 ka filluar projekti për zbatimin e Sistemit të Menaxhimit të Energjisë së Ndërtesave, i cili mbështetet nga zbatimi në vitet e fundit të Përmirësimit të Infrastrukturës Elektrike dhe Sistemeve të Menaxhimit të Ndërtesave, ku janë zëvendësuar të gjitha pajisjet me ato me efikasitet të lartë në ambientet e Zyrave Qendrore dhe Dega Laprakë.

☉ Konsumi i energjisë:

Gjatë vitit 2022 filloi projekti për zëvendësimin e ndriçimit tradicional me ndriçim LED. Në vitin 2022 u finalizua studimi i leverdisë ekonomike për instalimin e impianteve fotovoltaike për konsum vetjak në Rrugën e Barrikadave dhe Degën Kombinatat. Zbatimi i Projektit është parashikuar për vitin 2023.

b) Emetimet direkte:

Zëvendësimi i automjeteve ekzistuese të korporatave me vetura elektrike është një projekt në vazhdim e sipër dhe synon zëvendësimin e plotë deri në vitin 2025. Për më tepër, nevojat shitesë të biznesit për automjete do të plotësohen me automjete elektrike.

c) Reduktimi i letrës:

Konsumi i letrës u reduktua me 8.7% (ose 6,167 kg) nga menaxhimi më i mirë dhe nga aplikimi i firmës online dhe e-aleat.

OTP Bank Albania ka vënë në dispozicion kredinë GEFF për një numër të madh familjesh duke kontribuar kështu në suksesin e përgjithshëm të programit GEFF në Ballkanin Perëndimor. Në kuadër të këtij programi dhe për të vlerësuar të gjitha përpjekjet e stafit, çmimi BERZH ishte dhurimi i 20 pemëve dhe mbjellja e tyre në të gjithë Ballkanin Perëndimor në emër të OTP Bank Albania. Pemët do të jenë një trashëgimi e qëndrueshme për brezat e rinj dhe një shtysë për Bankën OTP Albania në misionin e saj për promovimin e eficiencës së energjisë.

BERZH, me qëllim përmirësimin eficiencës së energjisë në Shqipëri, uljen e ndikimeve negative në kushtet klimaterike dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së individit, ka ofruar një linjë kredie prej 3 milionë euro për **ProCredit Bank**. Ky fond do të nxisë realizimin e investimeve në: izolimin e mureve ose çatisë, dritare apo dyer të reja, panele diellore, pompa ngrohje ose kaldaja më të pastra dhe efikase me synim kursimin e energjisë. Pas përfundimit të suksesshëm të investimeve, familjet kanë mundësinë të marrin grant stimulues me vlerë nga 15-20% të kredisë, financuar nga BE, duke e bërë investimin financiarisht më të përballueshëm.

Raiffeisen ka instaluar dhe ka në funksion tre impiante fotovoltaike në godinën e zyrave qendrore në kompleksin Kika (84.53 kwp), Fier (38.52 kwp) dhe Berat (17.12 kwp) me prodhim vjetor rreth 180,000 kwh energji elektrike ose 5% e sasisë vjetore të konsumit të energjisë elektrike në bankë. Është në fazën e implementimit edhe impianti fotovoltaike në degën e Kukësit me fuqi dalëse 22 kwp ose prodhim vjetor 27,300 kwh energji elektrike. Objektiv është shtimi i impianteve fotovoltaike në sa më shumë degë.



OBJEKTIVI #8 Punë dinjitoze dhe Rritje Ekonomike

* Hua për turizëm

419 kredi të reja të dhëna gjatë vitit në vlerën **9.48** miliardë lekë.

Teprica e kredisë në fund të vitit 2022: **18.62** miliardë lekë.

* Mbi **1.5** milionë lekë kontribut nga bankat në mbështetje të projekteve për komunitetit.

Nëpërmjet një partneriteti të ri të nënshkruar mes **Bankës Amerikane të Investimeve** dhe UNDP Albania, banka financoi një shumë prej 100,000 USD për të mbështetur 50 biznese mikro dhe të vogla në rimëkëmbjen nga pasojat e tërmetit. Këto biznese mbështeten nëpërmjet metodologjisë “In Motion”, e cila është aplikuar me sukses nga UNDP në vendet e prekura nga fatkeqësitë natyrore, duke përfshirë edhe Shqipërinë. “In Motion” synon të stabilizojë kushtet ekonomike të bizneseve mikro dhe të vogla, të rivendosë dhe të përmirësojë veprimtaritë e tyre ekonomike në treg.

Banka Kombëtare Tregtare:

- Për kategorinë e pensionistëve, ofron një sërë shërbimesh falas, si: llogari rrjedhëse dhe kursimi pa komision, pagesa automatike të faturave pa komision, urdhër pagesa periodike pa komision, etj. Njëkohësisht mund të marrin pensionin e tyre në llogarinë në BKT.
- Për studentët ofrohet mundësia e hapjes së llogarisë dhe përfitimeve të produkteve bankare pa komision, si dhe Kredi për Student me kushte preferenciale.

Fibank Albania, në bashkëpunim me Digital Academy Albania, zhvilloi për të gjithë stafin një trajnim transformues mbi rritjen e prezencës dhe komunikimit digjital dhe strategjive për të edukuar më shumë klientë, krijuar marrëdhënie efektive me ta, dhe gjeneruar vazhdimisht shitje.

Intesa Sanpaolo Bank Albania ofron Paketën e Studentëve (Student Package) dhe Paketën e të Rinjve (Youth Package). Aplikimi online për paketën e të rinjve (Light onboarding) dedikuar të rinjve nga mosha 18-25 vjeç ka si qëllim t'i ofrojë klientëve të mundshëm një proces të thjeshtë të orientuar drejt teknologjisë duke ofruar një përvojë novatore përdorimi, që për lehtësi mund të fillohet online dhe më pas të përfundojnë procesin në degë me prani fizike. Klientët që plotësojnë aplikimin online kanë prioritet kur vizitojnë degën dhe për më tepër përfitojnë nga Paketa e të Rinjve, e cila ofrohet me kushte shumë preferenciale për të rinjtë dhe pa pagesë për mbajtësit e kartës së studentit nga Bashkia e Tiranës apo Agjencia e të Rinjve.

OTP Bank Albania:

- Në mbështetje të promovimit të turizmit shqiptar, sponsorizoi panairin “Vizito Devollin”. Ky panair u zhvillua në muajin gusht në fshatin Ziçisht. U bë pikërisht përzgjedhja e këtij fshati si një ndër vendet me më tepër tradita dhe kulturë në zonën e Devollit. Me dashamirësinë e banorëve, me gatimet tradicionale dhe zakonet e tyre, panairi synoi të shndërronte fshatrat turistike të Devollit, në disa destinacione kryesore turistike.

- Në Ditën Kombëtare të Vajit të Ullirit, mbështeti panairin i cili u organizua në datën 19 qershor, në qytetin bregdetar të Vlorës. Në panair morën pjesë kompanitë shqiptare të prodhimit të vajit të ullirit dhe nënprodukteve të tij nga Tirana, Elbasani, Vloja, Berati, Delvina dhe Lukova. Gjithashtu, vizitorët u prezantuan me një sërë produktesh artizanale.



Onboarding Programme është tashmë një praktike e përvitshme e **ProCredit Bank** me qëllim trajnimin, zhvillimin personal dhe profesional si dhe punësimin e të rinjve të sapo diplomuar. ProCredit Bank investon në realizimin e 8 programeve onboarding çdo vit, duke mirëpritur si pjesë të stafit kolegët e rinj. Ky program ka si pjesë të tij të integruar trajnime teorike dhe praktike, gjithashtu zhvillohet në koherencë të plotë me bankat simotra në rajon. Të rinjtë kanë mundësinë të trajnohen në qendrën e trajnimeve në Beograd, se bashku me koleget e tjerë të rinj të bankave rajonale ProCredit.



Union Bank:

- Banka prezantoi kartën “2 në 1”, karta e parë financiare MasterCard dedikuar studentëve. Lëshimi i kësaj karte vjen si një bashkëpunim ekskluziv i Union Bank dhe Bashkisë së Tiranës, duke mundësuar në një kartë të vetme të gjitha karakteristikat dhe përfitimet e kartës së studentit dhe ato të kartës financiare.
- Krahas kartës, studentëve u vihet në dispozicion një paketë e plotë me kushte të favorshme që i fton ata të nisin përdorimin e produkteve bankare që në auditorët e universitetit (llogari rrjedhëse, kartë, online banking).
- Një tjetër risi e ofruar është Llogaria e Kursimit dedikuar fëmijëve deri në 18 vjeç. Veçanti e kësaj llogarie qëndron në ofrimin e një bonusi nga banka si dhuratë për ditëlindje. Kjo llogari mundëson përfitim bonusi për ditëlindje dhe lejon mundësinë që çelja të bëhet jo vetëm nga prindërit, por edhe të afërm të tjerë.
- Prezantoi paketën “Harry Fultz” në bashkëpunim me Institutin Harry Fultz, një paketë me produkte dhe shërbime bankare me kushte preferenciale, të dedikuara për nxënësit që kryejnë studimet pranë këtij institucioni. Prezantimi u realizua përballë një auditori nxënësish dhe stafit pedagogjik të Institutit “Harry Fultz”.
- Ishte pjesëmarrës në Panairin e Turizmit (ITE Days) në datat 2 - 4 qershor. Gjatë sezonit turistik banka mbështeti zhvillimin e turizmit në vend, duke ardhur me paketa të dedikuara posaçërisht për bizneset e këtij sektori dhe plotësuar nevojat e tyre për investime dhe zgjerimin e aktivitetit.



Credins Bank, Procredit Bank dhe **Union Bank** ishin pjesëmarrëse në Panairin e Punës dhe Aftësive Syn+Ergasia zhvilluar në datat 23-24 shkurt, i cili ishte një mundësi e mirë për publikun dhe për të gjithë punëkërkesit për të krijuar kontakte të vlefshme si dhe mundësi punësimi e zhvillimi profesional.



OBJEKTIVI #9 Industri, Inovacion dhe Infrastrukturë

* Hua për SME

Mbi **3,881** kredi të reja të dhëna gjatë vitit në vlerën mbi **59.6** miliardë lekë.

Teprica e kredisë në fund të vitit 2022: mbi **146.18** miliardë lekë.

* Hua për infrastrukturën

256 kredi të reja të dhëna gjatë vitit në vlerën **7.44** miliardë lekë.

Teprica e kredisë në fund të vitit 2022: **11.3** miliardë lekë

* Hua për Hua për high-tech (teknologji)

31 kredi të reja të dhëna gjatë vitit në vlerën **756** milionë lekë.

Teprica e kredisë në fund të vitit 2022: **1.61** miliardë lekë.

* Mbi **1.1** milionë lekë kontribut nga bankat në mbështetje të komunitetit.

Procredit Bank:

- Ishte pjesë e prezantimit të Programit të BERZH, i cili synon nxitjen e konkurrencës së SME-ve në vend. Procredit është një ndër dy bankat partnere të këtij programi.
- U përfaqësua për të dytin vit radhazi në Konferencën Think Tech. Përfaqësuesja e bankës mbajti një prezantim në lidhje me digjitalizimin dhe sigurinë e të dhënave të klientëve.

Union Bank:

- Në bashkëpunim me Protik Innovation Center organizoi konkursin 3-ditor "Hackathon". Në këtë aktivitet morën pjesë studentë, të cilët patën mundësi të propozojnë idetë e tyre për zhvillimin e sistemeve të bankës si dhe të njihen nga afër me stafin e profesionistëve nga Union Bank.
- Mbështeti çmimet për tre skuadrat fituese me idetë më të mira të prezantuara në "Good Start UP

School”, i cili u zhvillua në qytetin e Shkodrës me pjesëmarrjen e të rinjve nga 5 Bashkitë e Qarkut. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte fuqizimi i të rinjve drejt sipërmarrjeve të suksesshme dhe përgatitja e tyre, duke nxitur rritjen e bizneseve të reja dhe absorbimin e metodologjive dhe praktikave më të mira të vendeve evropiane.

- Sponsor i konkursit “Ndërto të ardhmen” për diplomat më të mira të studentëve të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, i cili u organizua gjatë panairit “Build and Live Smart Expo 2022” organizuar nga Expocity Albania. Union Bank mundësoi çmimet për 3 diplomat më të mira të paraqitura në këtë konkurs.



OBJEKTIVI #10 Zvogëlim i Pabarazive

* Iniciativat CSR të ndërmarra gjatë vitit rreth **3** milionë lekë.

Banka Amerikane e Investimeve:

- Mbështet për herë të parë në Shqipëri projektin pilot mbi studimin e Çrregullimit të Pamjaftueshmërisë së Vëmendjes me Hiperaktivitet (ADHD) tek fëmijët e moshës 7-10, të ndërmarrë nga Medical Institute of Albania (MIA). Ky projekt do të shtrihet për një periudhë 18 mujore, me qëllim ndërgjegjësimin, parandalimin, identifikimin, diagnostikimin, trajtimin në kohë dhe rritjen e kapaciteteve të profesionistëve që menaxhojnë popullatën me ADHD.
- Në kuadër të luftës kundër diskriminimit, mbështeti për të pestin vit radhazi “Mbrëmjen Gala të Bamirësisë”, të organizuar në Tiranë në datën 31 maj, nga aktivistët e komunitetit LGBT. Misioni i këtij aktiviteti ishte sigurimi i fondeve për vazhdimësinë e akomodimit, ushqimit, mbështetjes psiko-sociale, aftësimin për jetën, edukimin dhe punësimin për të rinjtë LGBT, të cilët janë viktimat e abuzimit dhe diskriminimit dhe jetojnë pranë Qendrës “Streha”.
- Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Shkopit të Bardhë, më 15 tetor, banka mbështeti koncertin e organizuar nga ansambli i vokalit “Joy of Singing”, me qëllim aktivizimin në jetën artistike të personave me aftësi të kufizuara në shikim dhe ofrimin e shanseve të barabarta për integrimin e këtij komuniteti në shoqëri.

Intesa Sanpaolo Bank Albania feston disa ditë ndërkombëtare (sipas kalendarit të Kombeve të Bashkuara) në lidhje me diversitetin në një spektër më të gjerë, si: *Dita Ndërkombëtare e Vëllazërisë Njerëzore, Dita e Zero Diskriminimit, Dita Ndërkombëtare Kundër Gjuhës së Urrejtjes, Dita Botërore e Diversitetit Kulturor për Dialog dhe Zhvillim, Dita Botërore e Refugjatëve, Dita Botërore e Aftësive Rinore, Dita Ndërkombëtare e Solidaritetit Njerëzor*, etj.

Gjithashtu, banka solli në vëmendje rëndësinë e Ditës Ndërkombëtare të Ndërgjegjes dhe vuri në dukje se për të shpëtuar brezat e ardhshëm nga plagët e luftës, kërkohet një transformim drejt një kulture paqeje.





Për Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës së Shenjave, një kartolinë simbolike u dërgua për çdo punonjës të bankës dhe u postua gjithashtu në rrjetet sociale. Në këtë mënyrë, Intesa Sanpaolo Bank Albania synon të promovojë përdorimin e gjuhëve të shenjave në çdo fushë të jetës sonë, si një mënyrë për të inkurajuar identitetin gjuhësor dhe diversitetin kulturor të të gjithë njerëzve që nuk dëgjojnë.

Gjatë kohëve të vështira për të gjithë botën, të cilat u krijuan për shkak të luftës Rusi-Ukrainë, **OTP Bank Albania** ka ofruar mbështetje për të strehuar dhe ndihmuar një numër të konsiderueshëm qytetarësh nga Ukraina.

Procredit Bank përzgjedhi një kartolinë të krijuar nga 9 vjeçari Rean pjesë e organizatës “Down Sindrom Albania”. Fondet e mbledhura nga blerja e kartolinave të punuara me dorë nga fëmijët e këtij institucioni, shkojnë për mbulimin e një pjese të shpenzimeve terapeutike për këta fëmijë.

Union Bank mbështeti për të dytin vit radhazi aktivitetin “Të drejta të barabarta për mundësi të barabarta” të organizuar nga shoqata “RESS-Egnatia”, në bashkëpunim me Bashkinë e Elbasanit dhe Këshillin e Qarkut Elbasan. Ashtu si dhe vitin e kaluar, ky aktivitet kishte në qendër të tij angazhimin dhe përfshirjen e fëmijëve me çrregullim të spektrit autik (ÇSA) në aktivitete sociale dhe sportive. Rreth 200 fëmijë patën mundësi për dy ditë rresht të merrnin pjesë në gara sportive dhe lojëra të ndryshme, nën kujdesin e prindërve dhe instruktorëve të specializuar.



OBJEKTIVI #11 Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme

* Hua për shtëpi të reja

4,207 kredi të reja të dhëna gjatë vitit në vlerën **33.04** miliardë lekë.

Teprica e kredisë në fund të vitit 2022: **74.07** miliardë lekë.

* Mbi **38** milionë lekë në mbështetje të veprimtarive që promovojnë artin, kulturën dhe traditën.

Banka Amerikane e Investimeve:

- Mbështeti edicionin e 18-të të Festivalit Ndërkombëtar të Vokalit Operistik “Marie Kraja”, që u zhvillua në datat 29 -30 mars në Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit.
- “Land & Sand Art Festival”, u zhvillua për herë të parë në Shqipëri, si një risi e artit në rërë. Artistë nga vende të ndryshme të Evropës u bënë bashkë për të ndërtuar në bregdetin e Velipojës skulpturat e tyre prej rëre.
- Në cilësinë e sponsorit të përgjithshëm, mbështeti aktivitetet e organizuara në Vlorë, për 110-vjetorin e Pavarësisë Kombëtare.
- Mbështetëse e edicionit të 5-të të Swing Marathon, mbajtur në 30 prill, në Shkodër.
- Në kuadër të festivalit Gjon Mili dhe Javës Amerikane në Korçë, banka mbështeti “videoLAB” në Muzeun Gjon Mili, një laborator i pajisur me mjetet e domosdoshme për të rinjtë e pasionuar në video art dhe fotografi.

Banka Kombëtare Tregtare:

- Mbështeti aktivitetet festive të Ditës së Verës në Elbasan. Të gjitha aktivitetet e ndërmarra synuan promovimin e rajonit, vlerat e tij kulturore dhe artistike. Risia e këtij aktiviteti ishte organizimi për herë të parë sipas traditës së Sofrës Elbasanase. Sofra u organizua në oborrin e shtëpisë së Biçakcive (sot Muzeu Etnografik).
- Mbështeti ekspozitën e titulluar “ACTA URBANA” një nga projektet dhe angazhimet më të mëdha të artistit, krijuesit dhe grafikut Petraç Papa. Kjo vjen pas një pune të gjatë gati 10 vjeçare të autorit me krijimin e shumë pullave filatelike, monedhave numizmatike dhe kartëmonedhave, dy prej të cilave janë aktualisht të pranishme në tregun shqiptar dhe përkatësisht ato me vlerë 2 000 lekë (Mbreti Gent) dhe së fundmi emetimi i kartëmonedhës 10 000 lekë (Asdreni) emetuar nga Banka e Shqipërisë.

Credins Bank është gjithmonë pranë artit dhe artistëve të talentuar. Si shumë vite radhazi, dhuroi mbështetje për veprimtari kulturore që promovojnë vlerat tona dhe dhurojnë argëtim për komunitetin si dhe promovojnë kultura dhe eksperiencat e ndryshme e të veçanta.

Veprimtari kulturore të mbështetura nga Credins Bank:

- Finalja e “Tirana Art Fest”, një konkurs në mbështetje të të rinjve të talentuar nga gjimnazet e Tiranës në fusha artistike si muzikë, kërcim, instrument dhe multimedia.
- Koncerti “I këndojmë Paqes” nga organizata “Fëmijët për Fëmijët”.
- Gjon Mili Jazz & Blues Festival në Tiranë dhe Korçë.
- International Folk Festival “Maratona Këngës Popullore në Tiranë dhe Vlorë.
- Hemingway Jazz Fest, me pjesëmarrjen e artistëve të talentuar nga Italia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe Amerika Latine.
- Festival kulturor në Mat.
- Koncertin “Tre tenorët”.
- Himara International Music Festival.
- Festivali i Verës.
- Festivali Ndërkombëtar i Dancit Bashkëkohor.
- Koncerti i artistit Olen Cesari.
- Koncerti Gala “60 vjetori i Fakultetit të Muzikës”, me performancë nga Orkestra Filharmonike, Kori dhe solistët e Universitetit të Arteve.
- “Qyteti im Evropian” nga ABC Tirana Club organizuar në Korçë. Të rinj të talentuar në fushën e pikturës paraqiten idetë e tyre se si ata e perceptojnë qytetin e tyre ideal, me mjedise më të përshtatshme, më të gjelbra, e me hapësira të bollshme ku ata mund të argëtohen e të luajnë.
- Aktiviteti paragliding “Albania Open” nga Aeronautika Shqiptare.
- “Festivali Riteve 2022” nga Qendra Kulturore Mediatike Antigonea. Njëpërmjet edicionit të 6-të Festivalit të Riteve 2022 në Gjirokastrë, u promovua trashëgimia kulturore, turizmi, dhe natyra e veçantë e Gjirokastrës dhe zonave përreth.
- Edicioni i 4-t i “Tirana International Watercolor Festival” nga VIZart.
- Dibra N’Fest: muzikë, parada, panaire agro, promovim i artisteve, turizmit në Dibër si dhe kulturës së tyre nëpërmjet ekspozitave, sporteve si dhe vizitave në vende historike.
- “Festivali “Animals and Friends”, ku u performuan shumë nga këngët më të famshme të muzikës së viteve ’60-’70.
- Koncerti i këngëtarit “Janis Parios”.
- International Dance Academy Albania (IDAA), koncert koreografik zhvilluar në sallën qendrore të Teatrit të Operas dhe Baletit.
- Shkodra International Food Festival, mbajtur në Shkodër lidhur me kulinarinë dhe gastronominë.
- Katalogu “Rrugica ime dhe Tirana” nga Stefan Taçi, i cili promovon qytetin e bukur të Tiranës si dhe kujtimet e tija nëpërmjet veprave të bukura që ai ka realizuar ndër vite.
- Edicioni i tretë i “Vjosa River Volley”, në Përmet, ku përgjatë tre ditëve u zhvilluan seminare për mbrojtjen e lumit të Vjosës, aksione komunitare në



pastrim të plazheve publike përgjatë lumit, si dhe ndeshjet finale të kupës së volejbollit 2022 në kategori amatore dhe profesioniste.

- Dhuroi kontribut në festivalin Twinkle Twinkle, të cilët zhvilluan edhe edicionin e parë. Një konkurs kënge për fëmijë të cilët shfaqën talentin e tyre në muzikë, si dhe një mënyrë shumë e mirë për të spikatur talente të reja.
- Pogon Race, duke promovuar sportin e çiklizmit dhe turizmin e zonës së jugut të Shqipërisë.
- Albanian Dancing simulation si dhe aktiviteti tek TUMO për pjesëmarrësit e OriginAL nga organizata joqeveritare GERMIN, për t'u njohur me trojet Shqiptare dhe historinë e kombit tonë.
- Koncerti i këngëtarit me famë ndërkombëtare Maluma, organizuar në 14 Mars për ditën e verës.
- Digital Nomad Tirana: aktiviteti që erdhi për herë të parë në Shqipëri duke lidhur të pasionuarit pas teknologjisë kudo në botë me ekspertë, sipërmarrës të vendeve të ndryshme të botës, themelues start-upesh të suksesshme, drejtues korporatash dhe grupe të rinjsh. 47 folës me eksperiencë në fusha dhe vende të ndryshme të botës, sollën një atmosferë unike përgjatë 3 ditëve.
- Aktiviteti “Peza Adventure Festival”, i cili promovoi sportin si dhe vlerat turistike të Pezës.

OTP Bank Albania:


- “Katrori i Pushtetit” është serial shqiptar i dedikuar lirisë së medias dhe lirisë së shprehjes në vendin tonë, si dhe një tjetër bashkëpunim i suksesshëm i OTP Bank Albania në mbështetje të artit.
- Banka mbështeti realizimin e serialit “HOT - Humans of Tirana”, i cili i përket zhanrit dramë-komedi. Një histori me shumë dimensione, e cila adresoi fenomene sociale të kudogjendura.

Ndër veprimtaritë artistike të mbështetura nga **Raiffeisen** përmendim:


- Kalendarin artistik të TOB dhe Teatrit të Kukullave.
- Edicionin e 5-të të “South Outdoor Festival 2022”.
- Festivalin e filmit “Queer film fest”.
- Festivalin e komedisë në qytetin e Korçës “Koko fest”.
- ZA Fest festival.
- Check In festival.
- Festivalin e muzikës Klasike Pianodrom, etj.

Union Bank:

- Sponsor zyrtar i Colourday Festival, festivalit rinor të organizuar në Tiranë, i cili u zhvillua në datat 11 dhe 12 qershor në sheshin “Nënë Tereza”. Mbi 40 artistë shqiptarë e të huaj performuan në skenën e festivalit. Përgjatë ditëve të festivalit të rinjtë patën mundësinë të vizitonin standën e Union




CREAINS bank
the future is green



Bank ku u njohën nga afër me avantazhet e produkteve të dedikuara që banka ofron për ta, siç është Karta Junior, karta e parë e debitit për fëmijë dhe të rinj në Shqipëri.

- Ishte mbështetëse e aktivitetit “Festojmë së bashku Krishtlindjen”, i cili u zhvillua në formën e një maratone performancash artistike me pjesëmarrje të grupeve të të rinjve dhe fëmijëve artistë nga shkollat dhe qendrat artistike të Tiranës.
- “Tinguj Ballkani” spektakli muzikor i organizuar në datën 11 maj, solli në skenë për publikun e qytetit të Beratit, këngët dhe vallet e Ballkanit nga nxënësit e talentuar të shkollës së mesme artistike “Ajet Xhindole”. Ky projekt i realizuar me sukses në bashkëpunim me Bashkinë Berat dhe Zyrën Arsimore Vendore të këtij qyteti, kishte për qëllim promovimin e traditës, historisë dhe kulturës së vendeve ballkanike në Shqipëri.
- Ka vijuar mbështetjen për Kombëtaren Shqiptare të Futbollit, si vazhdim i marrëveshjes me Federatën Shqiptare të Futbollit.



* Kontributi i bankave për mjedisin rreth **2.5** milionë lekë

Banka Kombëtare Tregtare i është bashkuar nismës “Dhuro një Pemë” ndërmarrë nga Bashkia Durrës dhe Lushnjë për të rritur hapësirat e gjelbra në këto qytete.

Credins Bank:

- I bashkohet nismës “Bike to work Day” një nga aktivitetet e Javës Evropiane të Lëvizshmërisë, një nismë e përvitshme e Komisionit Evropian. Stafi iu bashkua kësaj nisme të bukur duke ardhur me biçikleta në punë. Për më tepër, banka ka ndërtuar shumë stacione të biçikletave në degët e saj.
- Aktiviteti Climathon Tirana 2022, synoi mbështetjen e 100 të rinjve novatorë me fokus përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe ndërgjegjësimin ndaj ndryshimeve klimaterike për t'i dhënë zgjidhje 5 sfidave klimaterike të qytetit të Tiranës.

Fibank Albania mundësoi rikonstrukcionin e një varke që i përket bashkisë Pustec. Kjo varkë përdoret në liqenin e Prespës. Bashkia Pustec është pjesë e qarkut të Korçës dhe ndodhet në Parkun Kombëtar të Prespës në anë të liqenit të Prespës.

Intesa Sanpaolo Bank Albania iu bashkua aktiviteteve të Divizionit Ndërkombëtar të Bankave Filiale të Grupit Intesa Sanpaolo për Ditën Botërore të Mjedisit. Tema e fushatës ishte “Vetëm Një Tokë- #VetëmNjëTokë”. Nga data 1 – 3 qershor punonjësit e bankës morën disa informacione interesante me fakte dhe shifra, si dhe kartolina në lidhje me Ditën Botërore të Mjedisit, të cilat u publikuan edhe në faqet zyrtare sociale të bankës. Në ditën e tretë, kjo fushatë u finalizua me një kuiz, i cili u plotësua nga kolegët përmes platformës e-learning. 5 fituesit e parë u ftuan një darkë me Drejtorin e Përgjithshëm

Ekzekutiv të Intesa Sanpaolo Bank Albania.

Banka promovoi disa Ditë Botërore sipas kalendarit të Kombeve të Bashkuara, si: Dita Botërore e Habitatit, Dita Botërore e Tokës, etj.

Në Ditën Botërore të Turizmit punonjësit dhe klientët e bankës morën disa informacione interesante për disa qytete turistike të Shqipërisë, të cilat u publikuan në faqet zyrtare sociale të bankës.

OTP Bank Albania ka kryer dhurimin e disa pemëve në Bashkinë Lushnjë dhe mbjelljen e disa të tjerave në rrugën “Mbreti Gent”, në qytetin e Durrësit.

Procredit Bank:

- Banka, në bashkëpunim me bashkinë e Tiranës, ndërtoi murin rrethues të qendrës sociale në Shkozë duke bërë ndarjen me lumin dhe duke e bërë më të sigurt qëndrimin në këtë qendër.
- Sunny Hill Festival mbërriti për herë të parë në Shqipëri, me mbështetjen e ProCredit Bank. Janë mirëpritur mijëra vizitë ProCredit Chill Zone, për lojra interaktive që stimulojnë edukimin financiar dhe përdorimin e shërbimeve digjitale.
- Përfaqësues të bankës u bënë pjesë e një workshopi i cili kishte për qëllim ndërtimin e një platforme të ideuar dhe dizajnuar në baza ekologjike. Një koncept i ri për të promovuar, edukuar dhe ndërgjegjësuar sesi shërbimet dhe bizneset ekologjike mund të dizajnohen në fokusin e ekonomisë rrethore dhe të kontribuojnë në një të ardhme të qëndrueshme. Përmes përfaqësuesve të saj banka kontribuoi në dhënien e njohurive në lidhje me aspekte të ndryshme bankare dhe ekologjike për këtë projekt.

Tirana Bank:

- Ka mbështetur traditën si partner zyrtar i festivalit mbarëkombëtar të gjysheve, “Nona”, që u mbajt në Përmet në datat 5 - 7 gusht. Magjia e kuzhinës së gjysheve, këngëtarët më të njohur dhe ngjyrat e të gjitha trevave na forcojnë besimin në misionin tonë për të përcjellë traditën brez pas brezi, duke mbështetur iniciativat më të mira.
- Dha kontribut në rritjen e hapësirave të gjelbra në zonën e Liqenit të Paskuqanit, nën moton “Gjelbëro, Mbill, Riciklo”. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Tirana Bank, z. Dritan Mustafa, i pranishëm në këtë aktivitet, theksoi se Tirana Bank do të vazhdojë misionin e saj për të kontribuar në gjelbërimin e zonave të qytetit dhe jo vetëm, si një investim i zgjuar për të ardhmen e qytetit dhe shoqërisë.

Union Bank me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe shtimin e hapësirave të gjelbra ka dhuruar 600 pemë ulliri, të cilat u mbollën në kompleksin e banimit Mangalem 21 ndërtuar nga kompania e ndërtimit Kontakt sh.p.k..



OBJEKTIVI #12 Konsum dhe prodhim i përgjegjshëm

* Hua konsumatore

50,764 kredi të reja të dhëna gjatë vitit në vlerën **25.75** miliardë lekë.

Teprica e kredisë në fund të vitit 2022: **49.04** miliardë lekë.

* Politika të riciklimit e zbatuar nga bankat

Për qëllime të kontributit në reduktimin e mbetjeve, **Banka Amerikane e Investimeve** zbaton:

- Drejtim të printimeve në zyrat qendrore dhe rrjetin e degëve, për shmangien e shpërdorimit të letrës.
- Asgjësim të letrës nëpërmjet shoqërive të riciklimit.

Intesa Sanpaolo Bank Albania ka përdorur rreth 18,125 kg letër të riciklueshme.

Raiffeisen ka një kontratë për asgjësimin dhe riciklimin e letrës.

Grumbullimi, asgjësimi dhe riciklimi i letrës në **Tirana Bank**, si një nga politikat më të rëndësishme për mbrojtjen e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, kanë rezultuar të suksesshme duke kursyer:

» Material i asgjësuar	24,060 kg
» Material i riciklueshëm	21,482 kg
» Kg dru	64,361 kg
» Litra ujë	680,984 lt
» Energji në kWh	140,242
» CO ₂ (gjatë prodhimit)	3,738 kg



OBJEKTIVI #13 Veprim për Klimën

* Hua të gjelbra

1,299 kredi të reja të dhëna gjatë vitit në vlerën mbi **3** miliardë lekë.

Teprica e kredisë në fund të vitit 2022: **5.14** miliardë lekë.

ProCredit Bank:

- Ofron kredi për makinë elektrike. Banka kujdeset të ofrojë të gjitha kushtet, përfshirë pikat e karikimit falas për 2 vite. Për të promovuar përdorimin dhe rritur ndërgjegjësimin për makinat elektrike, banka ka ndërmarrë fushata mediatike. U zhvilluan një sërë pjesëmarrjesh në emisione televizive nga staf i bankës, për të informuar në lidhje me shumë aspekte të këtyre mjeteve ekologjike.
- Ofron mbështetje në investimet eco në biznes, si: panele fotovoltaike; linja prodhimi efeciente; etj.. Kolaterali nuk është kusht për të bërë investime në biznes me afat deri në 7 vjet.

Raiffeisen Bank:

- Ofron financim me kredinë ESG (Environmental Social Governance) ose Green, financim i cili ofrohet për blerje apartamentesh të pajisura me certifikatë të efencës së energjisë (të ndërtuara prej janarit 2021).
- Sponsorizimi i sistemit të fotovoltaikeve në UBT dhe i projektit të pastrimit të plazheve para dhe pas hapjes së sezonit turistik.

Union Bank:

- I jep një rëndësi të veçantë mjedisit dhe financimit të investimeve në mbrojtje të mjedisit. Prej 4 vitesh banka ka një marrëveshje GEFF me BERZh. Falë këtij bashkëpunimi banka akordon kredi për klientët për investime në banesa që mundësojnë një përdorim eficient të energjisë dhe klienti përfiton grant 15% ose 20% të investimit.
- Shtoi në flotën e saj të automjeteve 10 makina 100% elektrike, me synimin për ta shtuar këtë numër në vijim, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në reduktimin e emetimeve të karbonit dhe mbrojtjen e mjedisit. Makinat 100% elektrike reduktojnë me 100% përdorimin e karburantit dhe nuk emetojnë CO₂, duke qenë zgjidhja më efektive për një ambient të pastër dhe të shëndetshëm për të gjithë.

Tirana Bank ka ofruar një produkt specifik për financimin e paneleve fotovoltaike, duke financuar deri në masën 100%. Ky produkt shkon në linjë me marrjen e masave për të luftuar ndryshimet klimaterike dhe efektet që sjellin ato.



* Kontribute të bankave për ambientin.

Intesa Sanpaolo Bank Albania:

- Vendosja e mbajtëseve të biçikletave (28 vende në Zyrat Qendrore, 14 vende tek Rruga e Barrikadave);
- Heqja e të gjithë gotave plastike nga përdorimi dhe zëvendësimi i tyre me gota porcelani individuale për të gjithë stafin;
- Vendosja e kontejnerëve kartoni për mbledhjen e letrave në Zyrat Qendrore dhe degë për t'u ricikluar.
- Digjitalizimi i proceseve dhe edukimi i klientëve për përdorimin e mjeteve elektronike të kryerjes së transaksioneve dhe shitjeve në vend të atyre me bazë letre. Gjatë vitit 2022, falë nënshkrimit elektronik të kualifikuar #withSIGN dhe dokumenteve të shkarkuara /ngarkuara përmes kanalit bankar online, u ruajtën 128,142 dokumente në total, 1,010,450 faqe të nënshkruara, të shkarkuara ose të ngarkuara online. Këto shifra nuk marrin parasysh numrin e transaksioneve të pagesave të kryera online, të cilat kursejnë të paktën një fletë letre nga vulosja nëse nuk kryhen në letër.
- Financimi për Kreditë e gjelbra: Më 5 tetor, banka mirëpriti partnerët dhe klientët e saj në një aktivitet kushtuar biznesit. Gjatë takimit u prezantuan mundësitë financiare për Investimet e Gjelbra, kryesisht për investime në panele fotovoltaike. Kushtet financiare lehtësuese kanë nxitur bizneset drejt Investimeve të Gjelbra. Banka inkurajon klientët të investojnë në ndërtesa rezidenciale ekologjike dhe promovon Qiranë Financiare për automjetet elektrike, si një teknologji më e mirë që synon reduktimin e emetimeve të karbonit dhe ndikimin pozitiv në cilësinë e jetës.

ProCredit Bank:

- Në kuadër të vazhdimit të sensibilizimit të reduktimit të përdorimit të qeseve plastike një përdorimshe, banka ka dhuruar për qytetarët 2,000 çanta pambuku. Këto çanta janë shpërndarë përmes supermarketeve ku u ofruan në vend të qeseve plastike. Banka ka dhuruar për stafin e saj çanta pambuku dhe gota qeramike me qëllim reduktimin e përdorimit të plastikes në institucion.
- Mirëpriti në një forum mbi 200 biznese të interesuara për të kryer investime në panele fotovoltaike. Të ftuar ishin dhe partnerë strategjikë si Ministria e Energjetikës, BERZh dhe kompani projektuese dhe zbatuese të paneleve fotovoltaike. ProCredit Shqipëri së bashku me ProCredit Kosovë dhe Serbi, morën pjesë në këtë



samit të zhvilluar në 26 dhe 27 tetor në Ankara.

- Ishte pjese e panairit “Green Fest 2022”, organizuar në Sheshin Skënderbej nga bashkia Tiranë. Këshilluesit e Biznesit në ProCredit Bank ishin të pranishëm në panair për të dhënë informacion mbi produktet dhe incentivat e bankës të dedikuara biznesit të vogël dhe të mesëm në sektorin e industrisë ushqimore.
- ProCredit Electric Stations është aplikacion i dedikuar për gjetjen e stacionit më të afërt elektrik. Ky aplikacion mund të shkarkohet në telefon celular.

Raiffeisen ka mundësuar:

- Reduktimin e CO₂ në masën 97 ton/vit si rezultat i instalimit të impianteve fotovoltaike.
- Reduktimi në masën 2% i konsumit të energjisë elektrike në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021.
- Shtimi i flotës së makinave elektrike me katër makina të reja.
- Ulja e konsumit të letrës në masën 8 % në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021.



OBJEKTIVI #14 Jeta nën ujë

* Hua për peshkim

119 hua të reja në vlerë **794** miliardë lekë të dhëna gjatë vitit;

Teprica e huas në fund të vitit 2022: **1.38** miliardë.



OBJEKTIVI #15 Jeta në Stere

* Financim për mbjellje

54 hua të reja në vlerë **358** milionë lekë të dhëna gjatë vitit;

Teprica e huas në fund të vitit 2022: **573** milionë.

OTP Bank Albania zhvilloi një sërë aktiviteteve përgjatë vitit, në linjë me strategjinë e bankës dhe kanë si qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës dhe shoqërisë në përgjithësi:

- Banka dhe kontributin në qytetin e Durrësit, në mbjelljen e disa rrënjëve pemë të llojit rrap. Pemët, të cilat u mbollën në një ndër rrugët kryesore në qytet, ndihmuan në rehabilitimin e hapësirave të gjelbra përgjatë saj.
- Në panairin e agrikulturës i cili u zhvillua në qytetin e Lushnjës, ishte pjesëmarrëse me standën e saj e cila përfaqësonte më së miri tematikën e panairit. Pjesë e standës ishin edhe 2 pemë të llojit ulli, të cilat pas përfundimit të panairit u dhuruan për Bashkinë Lushnjë dhe u mbollën në sheshin përpara bashkisë.



OBJEKTIVI #16 Paqe dhe Drejtësi, Institucione të Forta

- * Iniciativa dhe politika në zbatim, të cilat synojnë reduktimin e korrupsionit në të gjitha format dhe të dekurajimit të diskriminimit dhe sigurojnë transparencën e institucionit.

Shembull: Zbatimi në Intesa Sanpaolo Bank Albania

Banka ndjek të njëjtën qasje si Grupi Intesa Sanpaolo në kuadrin e angazhimit për të luftuar korrupsionin në të gjitha format, në rastet kur korrupsioni i referohet ofrimit ose pranimit, në mënyrë direkte ose indirekte, të mjeteve monetare ose përfitimeve të tjera, të cilat ushtrojnë ndikim tek përfituesi, me qëllim që të nxisë ose shpërblejë kryerjen e një funksioni /veprimi ose mos kryerjen e tyre. Për këtë arsye mbulon si “korrupsionin aktiv” (ofrimin) ashtu edhe “korrupsionin pasiv” (pranimin), dhe rastin kur është i përfshirë një organ publik (“korrupsioni publik”), si dhe marrëdhëniet midis individëve privatë (“korrupsioni privat”), kur korrupsioni ka për qëllim kryerjen e një akti që është shkelje e detyrave zyrtare të një individi (“korrupsioni i drejtpërdrejtë”), ose i cili ka si qëllim të tij kryerjen e një akti për shkak të detyrës (“korrupsioni indirekt”), ose kur “korrupsioni ekzistues” ose korrupsioni “pasues” në vijim të kryerjes dhe përbushjes së detyrave të punës.

Intesa Sanpaolo Bank Albania në luftën kundër korrupsionit bazohet në parimin e përgjithshëm “zero tolerancë”.

Banka ka hartuar dhe ka të publikuar për të gjithë punonjësit “Udhëzimin Kundër Korrupsionit”, i cili është bazuar në Ligjin 60/2016 “Për Sinjalizimin dhe mbrojtjen e Sinjalizuesve”, në praktikën më të mira ndërkombëtare, si dhe rregulloret të brendshme të bankës.

Në këtë kontekst Banka:

- ▢ u komunikon objektivat e kontrollit të nivelit të parë Njësive të Biznesit dhe strukturave të tjera operacionale përgjegjëse për zbatimin e tyre;
- ▢ monitoron në mënyrë periodike operacionet në sektorët që paraqesin rrezik në kontekstin e vlerësimit të rrezikut dhe, sipas rastit, kryen verifikimet e procesit;
- ▢ përcakton dhe monitoron veprimet korrigjuese të cilat nevojiten për zbutjen e rreziqeve të identifikuara për mosrespektimin e masave, të përfshira si pjesë të aktiviteteve të kontrollit.

Transparenca në një institucion bankar, mund të ndahet në dy pjesë të rëndësishme:

1. Transparenca kundrejt institucioneve mbikëqyrëse.

Transparenca kundrejt institucioneve mbikëqyrëse (kryesisht Bankës së Shqipërisë) rregullohet me procedurë të brendshme “Mbi përbushjen e kërkesave minimale të publikimit të informacionit nga banka”. Kjo procedurë është hartuar në përputhje të plotë me rregulloren nr. 60, datë 29.08.2008 “Mbi kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja”.

2. Transparenca kundrejt klientëve

Transparenca kundrejt klientëve (kryesisht individë) është një fushë e rregulluar nga disa burime, ndër të cilat veçojmë rregulloret e Bankës së Shqipërisë, ligjin nr. 9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”,

si dhe politikat e Grupit Intesa Sanpaolo. Të gjitha burimet e mësipërme janë përkthyer në rregullore e procedura të brendshme të detyrueshme për të gjithë stafin e bankës, ndër të cilat mund të përmenden:

- ▢ Rregullore për mbrojtjen e konsumatorit. Kjo rregullore është hartuar duke pasur parasysh dhe në respektim parashikimeve të: a) rregullores 48/2015 të BoA “Për kredinë hipotekare dhe konsumatore”; b) rregullores 59/2008 të BoA “Për transparencën e produkteve dhe shërbimeve bankare e financiare”; c) ligjit nr. 9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”; d) praktikave më të mira të BE të diktuar nga Grupi Intesa Sanpaolo.
- ▢ Procedura “Për administrimin e ankesave”. Kjo procedurë përcakton hapat procedurale dhe njësitë organizative të përfshira në procesin e administrimit të ankesave, si dhe mënyrat dhe afatet për kthimin e përgjigjeve.
- ▢ Të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me: a) financimin e klientëve individë, b) çeljen e llogarisë bankare, c) çeljen e depozitave. Të gjitha këto procedura janë hartuar duke pasur parasysh dhe në përputhje të plotë me parashikimet e rregullores 48/2015 të Bankës së Shqipërisë “Për kredinë hipotekare dhe konsumatore” dhe rregullores 59/2008 të Bankës së Shqipërisë “Për transparencën e produkteve dhe shërbimeve bankare e financiare”.

Veç sa më sipër, Banka u vë në dispozicion klientëve individë edhe dokumentacionin e mëposhtëm (i cili nuk është detyrim sipas kuadrit ligjor e rregullator lokal, por kërkesë e Grupit Intesa Sanpaolo):

- ▢ Të drejtat e klientit, dokument i cili bën një përmbledhje të të drejtave kryesore të klientit, dhe
- ▢ Key Fact Statement, i cili është një dokument që bën një përmbledhje të kushteve kryesore të të gjitha produkteve bankare që u shiten klientëve individë.



OBJEKTIVI #17 Partneritet për Objektivat

* Pjesëmarrje në iniciativa me shumë palë interesi që përkrahin zhvillimin e qëndrueshëm.

Në 16 qershor u zhvillua Ankandi i Dhurimit “Rrathë Dhurues 2022” nga “Partnerët Shqipëri” duke ofruar mbështetje financiare për disa kauza.

- **Banka Amerikane e Investimeve** ofroi mbështetje për dy prej kauzave të prezantuara: “Pop-up book!” një iniciativë që do të kontribuojë në krijimin e një hapësirë miqësore, letrare, dhe novatore në mjediset e shkollës “Ferraj”, e cila frekuentohet nga 148 nxënës, dhe “Nadja e mirë gjyshërit tanë!” iniciativës që do të kontribuojë në ndërtimin e një hapësirë rekreative për moshat e treta në qytetin e Shkodrës.
- **Banka Kombëtare Tregtare** mbështeti Albanian Center for Family Development (ACFD), në projektin “Fëmijë të shëndetshëm, komunitet i shëndetshëm!”.
- **Credins Bank** mbështeti kauzën “Fëmijë të shëndetshëm, komunitet i shëndetshëm”.

Banka Kombëtare Tregtare u bë pjesë e organizatës United Nations Global Compact - iniciativës më të madhe botërore për qëndrueshmërinë e korporatave dhe një organizatë ndërkombëtare me qëllim mobilizimin e kompanive globale që të ndjekin dhe zbatojnë 10 parimet mbi të drejtat e njeriut, punës, mjedisit dhe anti-korrupsionin.

Credins Bank:

- Mbështeti konkursin Colours of Albanians i cili ka në fokus promovimin talenteve në fushën e fotografisë, si dhe të vendeve të bukura të vendit tonë. Një organizim nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Shqipërisë si dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Kosovës, nga ku dolën dhe 6 fitues në ditën e pavarësisë së Kosovës.
- Kontribuoi në mbarëvajtjen e organizimit të 10 vjetorit të Ditës së Miqësisë së Gazetarëve Shqiptarë, një aktivitet 2 ditor, i cili u mbajt në qytetin e Prishtinës.
- Në bashkëpunim me organizatën Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim mbështeti “Konkursi i Bizneseve të Gjelbërta”. Credins u ofroi një ditë trajnim online aplikantëve të konkursit që ishin të interesuar për të mësuar më shumë rreth “Marketing dhe Promocion”.
- Dhuroi përkrahje për Konferencën “Mjeshtëro Biznesin”. Konferenca trajnoi pjesëmarrësit me njohuri, mjete, praktika dhe strategji për rritje të qëndrueshme afatgjatë të tyre dhe bizneseve të tyre.
- Koncertin “Rythm that Unites” dedikuar të rinjve për të promovuar mesazhe dhe vlera që na bashkojnë, si: integriteti, punësimi, barazia gjinore, mjedisi etj., për një zhvillim të qëndrueshëm të të gjithë shoqërisë. Ky aktivitet u mbështet në kuadër të “Global Goal Week” ku promovohet angazhimi i përbashkët i partneriteve ndërmjet shoqërisë civile, botës akademike, biznesit dhe shteteve anëtare të UN.
- Me rastin e 100 vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike të Shqipërisë me SHBA, banka mbështeti përkthimin e librit të ambasadorit të SHBA në Tiranë të vitit 1939 Hugh Grant.



Në vitin 2022 bankat kanë dhënë:

- 317 kredi të reja për agro-bizneset, në vlerën **1.75** miliardë lekë.
- 94 kredi të reja për spitale private dhe për mbulim shpenzimesh për arsye shëndetësore, në vlerën **1.39** miliardë lekë.
- 42 kredi të reja mbulim të shpenzimeve të arsimit, në vlerën **1.13** miliardë lekë.
- 140 kredi të reja për NMV-të që drejtohen nga femra, në vlerën **1.16** miliardë lekë.
- 178 kreditë reja për energji të rinovueshme, në vlerën **7.52** miliardë lekë.
- 419 kredi të reja për turizëm, në vlerën **9.48** miliardë lekë.
- 3,881 kredi të reja për NMV-të, në vlerën mbi **59.6** miliardë lekë.
- 256 kredi të reja për infrastrukturën, në vlerën **7.44** miliardë lekë.
- 31 kredi të reja për high-tech (teknologji), në vlerën **756** milionë lekë.
- 4,207 kredi të reja për shtëpi të reja, në vlerën **33.04** miliardë lekë.
- 50,764 kredi të reja konsumatore, në vlerën **25.75** miliardë lekë.
- 1,299 kredi të reja të gjelbra, në vlerën mbi **3** miliardë lekë.
- 119 kredi të reja për peshkim, në vlerë **794** milionë lekë.
- 54 kredi të reja për mbjellje, në vlerë **358** milionë lekë.